VENDIM
Nr. 652, datë 17.8.2020

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË VIKTIMËS SAMUEL NIK NDOJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , ligjit nr. 9936, datë 26.6.20008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, në shumën 500 000 (pesëqind mijë lekë), familjes së të miturit Samuel Nik Ndoj, të aksidentuar për vdekje gjatë operacionit humanitar të datës 15 gusht 2020, në afërsi të pikës së kalimit kufitar Kakavijë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.
3. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama